



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/СБОРНИЦА ОПШТИНСКОГ КЛУПА/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ
Nr. No. 01-060/09-0003843/25
Data Date 23.01.2025



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 pika 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385, i dt.03.12.2008, si dhe neni 5 Rregullores së Punë se Kuvendit, si dhe në pajtim me rregullat e procedurës për mbajtjen e mbledhjeve, Kryesuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu:

THËRRET

Mbledhjen e Rregullt të Kuvendit Komunal të Skenderaj, e cila do të mbahet me datë 30.01.2025, (ditë e enjte), me fillim prej orën 10:00, në Sallën e Kuvendit

Mbledhja do të ketë këtë:
REND DITE

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Shqyrtimi i Raportit financiar përfundimtar të buxhetit komunal janar-dhjetor 2024, me Nr. 02-052/01-0002664/25, i datës 17.01.2025, (Raporton drejtori i DBF-së, z. **Ismet Aliu**);
5. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.



KRYESUESJA E KUVENDIT

Znj. Adelina Spahiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA OPŠTINA
SKENDERAJ
Nr. 01-069/01-0003843/25
Data 23.01.2025
Data



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 49, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, të datës 03.12.2008, si dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrakt nga procesverbalit i MBLEDHJES SË KUVENDIT KOMUNAL SKENDERAJ,
i datës 24.12.2024, ora 10:00

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Draft-Plani i punës së kuvendit të komunës së Skenderajt për vitin 2025, (Raporton Krycsuesja e Kuvendit **znj. Adelina Spahiu**);
5. Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025, me Nr.02-463/01-0055311/24, të datës 11.12.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
Pika shtesë;
6. Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, (Raporton Kryetari i Komunës **z. Fadil Nura**);
7. Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, (Raporton drejtori i DSHP, **Alban Shala**);
8. Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme.

Krycsuesja e Kuvendit, znj. Adelina Spahiu: I nderuar kryetar i komunës Fadil Nura, të nderuar anëtar të kuvendit, drejtor të drejtorive, dhe gjithë ju të pranishëm, shkojmë në konstatime të kuorumit, në sallë janë 28 anëtar, mungon me arsye Ragip Durmishi, Besnik Ahmeti dhe Hysni Mehani.

Para miratimit të rendit të ditës i kemi dy pika shtesë:

-Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (18) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025. Vazhdojmë me pikën tjetër;

-Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, Shkojmë në votim për futjen në rend dite: Konstatojmë me (18) vota për, (10) kundër dhe (0) abstenim, futet në rend dite Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024.

Shkojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, fjalën ja kaloj;

Naser Bajraktari-IDEAL: Fjala përshëndetëse, të nderuar anëtar të kuvendit komunal, ne Lista IDEAL, largohem nga kjo seancë për të shprehur revoltën tonë ndaj qeverisjes komunale në Skenderaj, e cila vazhdon të mbaj në detyrë drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, pavarësisht së është

i dënuar me 2 vite e 6 muaj për bashkëpunim në Leposaviq. Ju bëjë thirrje të gjithë asamblistëve pa dallim pozitë opozitë mos u bëni dekor i kësaj qeverisje skandaloze lëshonc seancën dhe dërgoni një mesazh të qartë qytetarëve të Skenderajt se ne si përfaqësues të tyre jemi kundër këtij skandali dhe dënojmë fuqishëm mos veprimin nga kryetari Fadil Nura, dhe ju njoftojmë së Lista IDEAL, do ti bojkotojmë gjitha seancat e kuvendit derisa të shkarkohet drejtori i prokurimit.

Floriana Halili-LVV: Fjala përshëndetëse, edhe ne si Lëvizje vetëvendosje, kërkojmë shkarkimin e drejtorit Haxhi Bejta, dhe e lëshojmë mbledhjen.

Kryesuesja; Dikush tjetër, nëse nuk ka, Lista IDEAL dhe LVV, e lëshojnë seancën, për mos shkarkimin e drejtorin e prokurimit Haxhi Bejta, fjalën ja kaloj:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Fjala përshëndetës, e drejta demokratike është pjesë e demokracisë që së cili subjekt politik ka të drejtë të lëshoj seancën, po e ndjejë obligim me ju njoftua sa i përket kërkesës së opozitës, Haxhi Bejta si drejtor i prokurimit e ka ofruar dorëheqjen që 10 ditë, po pas festave të vitit të ri sigurisht do të aprovoj atë kërkesë, sepse kërkesën dhe vendimin e kam në tavolinë, po për faktin së nuk kemi drejtor të certifikuar të prokurimit edhe sot kemi pas pagesa që është dashur me i përfundua dhe parimisht Haxhi Bejta nuk është drejtor, dhe nuk bij në presione të opozitës në raste konkrete, është vendimi i gjykatës dhe do e respektoj vendimin e gjykatës dhe gjithçka është e qartë në këtë drejtim.

Kryesuesja, Dikush tjetër, nëse nuk ka konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, Miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës,

-Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara, e hapë debatin, nëse nuk ka shkojmë në votim;
Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës;

-Draft-Plani i punës së kuvendit të komunës së Skenderajt për vitin 2025, (Raporton);

Kryesuesja e Kuvendit Adelina Spahiu; Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2025, Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore. Këtë plan e kam hartua me bashkëpunim me sekretarin e kuvendit, janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne dhe urgjente, sipas LVL dhe Statutin e Komunës, e hap debatin nëse nuk ka, shkojmë në votim.

-Konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Skenderajt, për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025, Nr.02-463/01-0055311/24, dt.11.12.2024, (Raporton);

Kryetari i Komunës, Fadil Nura: Para vetes e keni një listë që është e njëjta e vitit të kaluar që na obligon ligji që ti listojmë listat e pronave që eventualisht mundën me qenë interes i komunës për dhënien në shfrytëzime duke i përfshirë pronat me qira, afatshkurtër, afatgjatë, listën e keni pas me kohe para vetes, ju ftojë me përkrah këtë listë.

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozim-vendim për miratimin e vendimit mbi publikimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

-Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025, Nr.02-112/01-0056311/24, datë 20.12.2024, (Raporton) **Kryetari i Komunës Fadil Nura**; Materialin e planit të punës së ekzekutivit nuk e kemi marr me kohe, sepse plani vazhdimisht ka qenë në seancën e janarit, po me qenë së e kemi si kritere për performancë është kërkuar ta prezantojmë në këtë seancë. Është një plan i hartuar nga ekzekutivi i cili përfshin aktivitetet angazhimet në arritjen e objektivave si ekzekutiv, ndoshta nuk është i përkryer, kërkojmë edhe nga ju të jepni kontributin aty ku e vlerësoni me ndonjë vërejtje kritik neper çdo drejtori.

Kryesuesja; E hap debatin, fjalën ja kaloj:

Sala Jashari-PDK: Fjala përshëndetëse, Komuna e Skenderajt ka bërë një pune të shkëlqyer gjatë vitit 2024 duke i adresuar shume nevojat e qytetarëve, duke investua në projektet e rëndësishëm, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve, disa kërkesa janë të cekura si kërkesa në këtë planë, po disa prej tyre po i ngritit për me i pas parasysh në vitin 2025 si: I. Shtrimi i rrugës në lagjen Nezap Prekaz i Epërm, me një gjatësi prej rreth 200m, që kjo rrugë është jetike për këta banor, si ja lehtëson punën e tokave bujqësore, lidh lagjen me varrezat, shkurton rrugën për nxënësit për në shkollë, dhe ndërtimin e një trotuari për sigurinë e fëmijëve dhe këmbësorëve? II. Kërkesë e banorëve të Runikut është ndërtimi i një trotuari në rrugën Tafë Hysenaj, për ta garantuar sigurinë e nxënëseve që përdorin këtë rrugë për të shkuar në shkollë? III. Kërkesë e banorëve është Kanalizimi dhe Infrastruktura në Kopiliq të Epërm në rrugën Daut Dervishi, 15 shtëpi nuk janë të kyçur në rrjet të kanalizimit, dhe disa rrugë në këtë fshatë kërkojnë renovime dhe disa rrugë kërkojnë ndërtim prej fillimi? Edhe në seancat e kaluara kam përmendur disa herë ndriçimin publik për rrugën që e ligje Prekazin e Ultë me pjesën e rrugës që të qon të lagjja Lushtak është e vetmja rrugë që nuk ka ndriçim? Këto janë kërkesat të qytetarëve që besoj do të reflektojnë në vitin 2025.

Miradije Buliqi-PDK: Fjala përshëndetëse, drejtor që nga fillimi i mandatit e deri me sot, shumicën e seancave dhe dëgjimeve publike që i kemi mbajtur në mesin e kërkesave që i kam bërë janë; Përfundimi i projektit të kanalizimit, Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumit, dhe Ndriçimi publik në fshatin Qubrel, a ka lëvizë diçka në këtë drejtim, a mundesh me na dhëne detaje dhe a ka gjasa me përfundua vitin e ardhshëm këto projekte?

Ali Lutfiu-PDK: Fjala përshëndetëse, desha me u ndërlidh të lagjja Nezap që e përmendi Sala, si kërkesë e kam bërë edhe unë për këtë rrugë, dhe e përkrahi kërkesën që e bëri Sala, dhe kërkoj shtimin e kësaj rruge dhe trotuarin për ata banor.

Besiana Thaçi-PDK: Fjala përshëndetëse, Në planin e punës të ekzekutivit, të pjesa e punimeve të ujësjellësit në Burojë figuron që ka përfunduar ky projekt, po me atë që unë di ky projekt në fsh. Burojë nuk ka përfundua, a mundesh me na sqarua? Të pjesa e trotuareve dhe ndriçimi publik neper BL, e kam bërë me herët një kërkesë për fshatin Kopiliq të Poshtëm për trotuar në rrugën Sejdi Reka, fatkeqësisht në këtë rrugë e kemi pas një aksident që ka përfundua me fatalitet dhe besoj që një ndërtim i një trotuari është shumë i nevojshëm? Gjithashtu të rruga Mula Ilaz Buroja edhe kjo rrugë ka nevojë për trotuar dhe kemi pas aksidente po fatmirësisht pa fatalitet? Të pjesa e rrugëve neper fshatra kam bërë kërkesë për fshatin Burojë që shpresoj që në vitin 2025 kanë me përfundua së nuk kanë mbete edhe shume.

Liridona Koci-PDK: Fjala përshëndetëse, Rrethoja e shkollës në Polac, nuk është ndërmarr diçka, e kam ngrit si çështje edhe me herët, është shumë e nevojshme kjo rrethoj për këtë shkollë sepse është shumë afër rrugës kryesore që paraqet rrezik për të madh për nxënësit? Një çështje tjetër që e kam ngritur edhe me parë, po edhe kam bërë edhe kërkesë me shkrim është numri i shtëpive, që nuk është ndërmarr as një veprim në këtë aspekt? Rregullimi i kanalizimit në disa lagje të Polacit

si dhe asfaltimi i rrugicave që këtë pyetje e kam parashtruar disa herë? Për DSHP, kur do të përfundon ndriçimi publik në Polac, në disa lagje veç ka përfundua?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Sala sa i përket trotuarit e kemi në kod buxhetor në këtë vite jemi në përfundim në Prekaz të epërm, dhe do të vazhdojmë aty ku ka prioritet, Ndriçimi publik është i përfshirë nëpër gjithë BL. Sa i përket, në fletën e fundit të drejtorisë sime është Asfaltimi i rrugëve neper fshatra janë 16.4 km, është kontrata me ministrin, dhe vitin e ardhshëm kemi me i përfundua. Kanalizimi në Kopiliq të epërm e kemi kontratën neper BL, dhe jemi tu i dhanë prioritet disa fshatra dhe vitin tjetër kemi me i përfundua të gjitha lagjet. Miradija, kanalizimi ne Qubrel e kemi premtua, po s'kemi buxhet, kontratën e kemi, vitin e ardhshëm kryhet. Ujësjetësi në Burojë e kemi cek që është përfundua dhe është i përfundua si projekt, tash e kemi kontratën kyqjet individuale dhe pothuajse jemi në përfundim. Liridona s'po kemi buxhet se tan rrugët i kishim përfundua.

Ali Lutfiu-PDK: Për drejtorin e urbanizmit, për planin e punës e kam një pyetje-kërkesë desha me ditë saktë, për tri familje në fshatin Polac ndërmjet lagjes Hoti dhe Koci ato familje krejt çka kanë ndërtua e kanë ndërtua me buxhet të vetin si kanalizimin si rrugën, saktësisht për familjen e Milaim Koces, dhe janë të interesuar vetëm për asfaltim të rrugës a është në plan të shtrohet kjo rrugë?

Kryesuesja: Fjalën ja kaloj:

Drejtori i DKA-së, Kastriot Duraku: Fjala përshëndetëse, Liridona e kemi një kontratë për renovim të shkollave, po jemi tu e pritë një përgjigje për çerdhe , dhe deri të marrim përgjigjen nuk po mundem me ndërhy për rregullimin e kësaj rrethoje, dhe nëse nuk marrim përgjigje do të intervenojmë në rrethoje.

Drejtori i DUMA-së, Driton Mulaj: Liridona për nr. e shtëpive, nuk kemi kontratë, për me i vendos numrat, kjo shkon përmes drejtorisë, vetëm qytetaret letë vinë të marrin një pëlqim dhe nuk kushton shumë numri le të blejnë vet. Të rruga e profes kemi me përfundua vitin e kaluar.

Kryesuesja: Dikush tjetër, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Plani i punës i ekzekutivit për vitin 2025.

Vazhdojmë me piken 6 të rendit ditës:

-Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, me Nr. 02325/04-0056708, datë 23.12.2024, (Raporton);

Drejtori i DSHP-së, Alban Shala; Fjala përshëndetëse, para vetes e kemi Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, Nr.09-325/04-0056629/24, të datës 23.12.2024, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024, Dëme janë shkaktuar në bujqësi dhe, në ekonomi familjare, në territorin e Komunës së Skenderajt, në vlerë totale prej 102,464.12€, kush ka pyetje jam këtu për përgjigje.

Kryesuesja: E hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (18) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Propozimit-vendimi për miratimin e raportit përfundimtar, si pasoj e fatkeqësive natyrore si erë, dhe zjarr, për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor 2024.

Vazhdojmë me piken 7 të rendit ditës, Pyetjet e këshilltarëve nën pikat të ndryshme, pyetjet kalojnë në seancën tjetër, me kaq mbyllet kjo mbledhje, shihemi në mbledhjen tjetër.

Procesmbajtësi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/OPŠTINA IPATRI
SKENDERAJ



Nr.
Data
02-052/01-0002664/25
17 09 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Zyra e Kryetarit /Kabinet Gradonacelnika / Office of the Mayor

RAPORTI PËRFUNDIMTAR
I BUXHETIT KOMUNAL
Janar – Dhjetor 2024

Janar 2025

Përmbajtja:

RAPORTI BUXHETOR JANAR-DHJETOR 2024.....	1
PËRMBAJTJA	2
1.TË HYRAT BUXHETORE PËRFUNDIMTARE SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE.....	3
TABELA NR 1: RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : Janar- Dhjetor 2024.....	4
2. TË HYRAT VETANAKE JANAR-DHJETOR 2024.....	6
3.SHPENZIMET BUXHETORE JANAR-DHJETOR 2024.....	8
4.INVESTIMET KAPITALE JANAR-DHJETOR 2024.....	10
5. SHPENZIMET ANALITIKE SIPAS PROGRAMEVE	13

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I BUXHETIT KOMUNAL

JANAR-DHJETOR 2024

KËRKESAT PËR RAPORTIM

Raporti i përfundimtar i buxhetit Komunal për periudhën Janar – dhjetor 2024, përgatitet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e nenit 46.2 të Ligjit Nr.03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Raporti Financiar Komunal ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

Periudha e raportimit karakterizohet me faktin se:

- të hyrat komunale të realizuara deri në shtator 2024 janë alokuar sipas planit buxhetor 2024 por në pjesën e tjetër të vitit është rishikuar plani i të hyrave komunale që ka rezultuar me realizim prej 93.55% të totalit ,

- të gjitha mjetet e pa shpenzuara nga tremujorët paraprak përmes procedurave të bartjes sipas rregullores financiare janë bartë në tremujorin në vijim për të gjitha kategoritë përjashtuar atë të pagave dhe

- me vendime gjyqësore/përmbartimore në emër shtesave (shujtat, licencimi, inflacioni etj.) bazuar në kontratën kolektive për mësimdhënës të arsimit parauniversitar janë pagua përmes Thesarit 2,455,186.46 € shumë e paguar nga kategoritë e ndryshme, nga sa janë paguar nga kategoritë janë të detajuar neper tabelat sipas analitikes .

TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”.

Buxheti i aprovuar për vitin 2024 ishte 18,582,310.00 € por me dhe ndryshimet pozitive gjatë vitit si: bartja e të hyrave komunale të pa shpenzuara nga viti paraprak, rishikimi i të hyrave komunale dhe granti i performancës (DEMOS-i) i shpërndarë në pesë kategori ekonomike është 21,304,423.13 €


Buxheti i planifikuar fillestar dhe pas rregullimeve për vitin 2024 ishte :

Kategoritë ekonomike	B. fillestar	B. aktual	% e planifikimit
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	11,719,493.30	55.01
Mallrat dhe Shërbimet	2,386,428.18	2,524,753.96	11.85
Shërbimet Komunale	289,322.82	344,126.71	1.62
Subvencionet	1,002,000.00	1,140,452.97	5.35
Investimet Kapitale	4,374,710.00	5,575,596.19	26.17
Gjithsej	18,582,310.00	21,304,423.13	100.00

TABELA NR 1 RAPORTI I BUXHETIT DHE EKZEKUTIMIT TË TIJ : JANAR- DHJETOR 2024

FONDET BURIMORE	Buxheti fillesar	Buxheti Aktual	Shpenzimet (pagesat) 2024	Shpenzimet (pagesat) 2023	% e realizimit
					3/2
0	1	2	3	4	5
GRANTI I PERGJITHSHËM	17,283,039.00	18,466,706.70	18,362,332.47	16,260,380.42	99.43
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	11,713,516.70	11,713,516.70	9,711,477.00	100.00
Mallrat dhe Shërbimet	2,329,428.18	2,329,428.18	2,313,067.04	2,340,775.35	99.30
Shërbimet Komunale	289,322.82	289,322.82	288,797.61	265,699.20	99.82
Subvencionet	932,000.00	932,000.00	931,185.38	860,661.42	99.91
Investimet Kapitale	3,202,439.00	3,202,439.00	3,115,765.74	3,081,767.45	97.29
Rezerva					
TË HYRAT VETANAKE Aktuale	1,299,271.00	1,884,271.00	1,659,388.45	1,607,214.65	88.07
Pagat dhe Shtesat		-		42,887.99	
Mallrat dhe Shërbimet	57,000.00	193,500.00	180,519.63	107,714.46	93.29
Shërbimet Komunale		35,000.00		25,179.38	-
Subvencionet	70,000.00	183,500.00	144,656.49	104,000.00	-
Investimet Kapitale	1,172,271.00	1,472,271.00	1,334,212.33	1,327,432.82	90.62
Rezerva					-
TË HYRAT E BARTURA	-	344,349.32	322,124.37	417,798.12	93.55
Pagat dhe Shtesat					-
Mallrat dhe Shërbimet		1,825.78	1,407.00	25,927.29	77.06
Shërbimet Komunale		19,803.89	14,324.31	26,989.80	72.33
Subvencionet		24,952.97	21,896.80	29,268.03	87.75
Investimet Kapitale		297,766.68	284,496.26	335,613.00	95.54
DONACIONET	-	609,096.11	609,096.11	419,981.02	100.00
Pagat dhe Shtesat		5,976.60	5,976.60	6,406.30	100.00
Mallrat dhe Shërbimet			-	-	
Shërbimet Komunale				-	
Subvencionet					
Investimet Kapitale		603,119.51	603,119.51	413,574.72	100.00
GJITHSEJ K.EKONOMIKE	18,582,310.00	21,304,423.13	20,952,941.40	18,705,374.21	98.35
Pagat dhe Shtesat	10,529,849.00	11,719,493.30	11,719,493.30	9,760,771.29	100.00
Mallrat dhe Shërbimet	2,386,428.18	2,524,753.96	2,494,993.67	2,474,417.10	98.82
Shërbimet Komunale	289,322.82	344,126.71	303,121.92	317,868.38	88.08
Subvencionet	1,002,000.00	1,140,452.97	1,097,738.67	993,929.45	96.25
Investimet Kapitale	4,374,710.00	5,575,596.19	5,337,593.84	5,158,387.99	95.73
Rezerva			-	-	

Raporti i shpenzimeve Janar-Dhjetor krahasuar me buxhetin aktual 2024



Shpjegim: Tabela nr.1

Pagat dhe shtesa:

Komuna me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2024 ka pasur të lejuar gjithsej 1329 të punësuar në të gjitha programet dhe nën programet buxhetore, kurse shumën e buxhetit në fund të vitit ishte 11,719,493.30. Shprehur në përqindje realizimi i buxhetit final për paga dhe shtesa ishte 100.00 %. Prej tyre në emër të pagesave nga Vendimet përmbartimore Gjyqësor për paga përcjellëse, jubilarë dhe shujta janë paguar 1,455,615.43 € d.m.th 12.42 % e buxhetit të lejuar për paga dhe shtesa. Sipas fondeve të financimit ashtu siç është prezantuar edhe në tabelë shumën prej 11,713,516.70 € janë paguar nga Grantet Qendrore ndërsa shumën prej 5,976.60 € nga Donacionet.

Mallrat e shërbimit:

Realizimi në mes të buxhetit final dhe realizimit real të buxhetit të kategorisë ekonomike – mallra dhe shërbime është 2,494,993.67 € ose 98.82 %, shumë e konsideruar është paguar në shpenzime: Shërbime kontraktuese tjera, shpenzime për dru, mirëmbajtja e shkollave dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale, furnizime për zyre, derivate për automjete, mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve, Sigurimi fizik i objekteve publike etj në shumë prej 1,333,176.33 € ose 53.44 % e totalit të kësaj kategorie.

Shërbimet Komunale:

Realizimi i shpenzimeve komunale 88.08 %. Si praktikë e zakonshme dhe domosdoshmëri faturat për shërbime komunale për muajin e fundit të vitit fiskal barten si obligime për vitin në vijim.

Subvencionet dhe Transfere:

Subvencionet kishin një rritje të konsiderueshme në krahasim me planin fillestar që ishte 1,002,000.00 € dhe gjatë vitit me bartje të THV në dhe rishikim të planit të THV-ve një buxhet prej 1,140,452.97 €, e të shpenzuar 1,097,738.67 €, shprehur në përqindje realizimi i tyre janë 96.25 %. Shpenzimi i tyre ishte bërë për pagesën e

bursave për student, subvencionimi i bujqve me pajisje përcjettese bujqesore, subvencionimi i shërbimeve të varrimit, subvencionimi i klubeve sportive, ndihma momentale të qytetarëve me rastin e sëmundjeve të ndryshme etj.

Investimet Kapitale:

Investimet kapitale janë shpenzua 95.73 % nga buxheti final kryesisht projektet kapitale janë realizuar në ndërtimin e rrugëve, renovimi i objekteve arsimore, Ndriçimi publik në fshatra në zona rurale, ujësjellës dhe kanalizime, trotuare, Vazhdimi i punimeve të kompleksi i UÇK-së - Objekti i U-së, Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, QMF-së dhe AMF-ve etj. në detale shihen në tabelën e projekteve kapitale nr. 4.

2.TË HYRAT VETANAKE JANAR-DHJETOR 2024

Përveç Grandeve të pranura nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka inkasuar edhe të hyra vetanake e të cilat të hyra janë për 93.55 % e planifikimit fillestar dhe të rishikuar, po që nuk janë alokuar për vitin përkatës për shpenzim për shkak të procedurave ligjore. Ekzistojnë disa lloje kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimi në pronë, gjobat e trafikut, taksa administrative për leje ndërtimi, shërbimet e kadastrave, taksa për regjistrimin e automjeteve etj. të cilat kanë rëndësi të madhe për buxhetin e përgjithshëm komunal.

Në tabelën e radhës nr.2 janë prezantuar të hyrat vetanake komunale dhe shikuar sipas kolonave, nr.2 tregon Programin dhe nën programin buxhetor dhe kategoritë ekonomike të realizimit të hyrave, kolona e dytë tregon llojin e të hyrave vetanake buxhetor sipas kodeve ekonomike të tyre, kolona 4 tregon planifikim 2024, kolona 5 realizimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2024, kolona 6 realizimin e të hyrave 2023 dhe kolona 7 tregon përqindjen e realizimit në raport me planin 2024.

Tatimi në pronë konsiderohet si e hyra kryesore e rregullte komunale. Komuna ka realizuar 56.48 % në raport me planifikimin, kjo rënie është edhe si rezultat i faljes së borxhit deri në 100.00 € për të gjithë obliguesit e këtij tatimi sipas ligjit nr. 08/L-224, neni 11/B dhe të gjithë obligimet e kryera gjatë vitit 2023 deri në atë shume janë llogaritur si parapagime. Lejet e ndërtimit dhe koncesionet gjithashtu si të hyra me % me të lart në TH komunale.

Në tabelën e prezantuar me poshtë janë të paraqitura të hyrat komunale sipas nën programeve dhe llojit të të hyrave me shuma.

TABELA NR. 2

PASQYRA

e të hyrave vetanake sipas drejtorive, planifikuara dhe realizuar në periudhën: Janar - Dhjetor 2024

Nr.	Përshkrimi	Kodi	Planifikimi		Realizimi		% e planit
			2024	2024	2023	5/4	
1	2	3	4	5	6	7	
I	Administrata dhe personeli	16323	72,590.00	64,202.04	57,936.85	88.44	
1	Çertifikatë lindjeje	50013	3,670.00	3,563.92	3,435.00	97.11	
2	Çertifikatë kurorëzimi	50014	8,620.00	3,594.00	3,740.00	41.69	
3	Çertifikatë vdekjeje	50015	3,610.00	1,954.00	2,865.00	54.13	
4	Çertifikatë – vërtetime të tjera ofiqarike	50016	52,950.00	37,302.00	45,490.00	70.45	
5	Taksa administrative	50019	3,740.00	854.00	1,152.30	22.83	
6	Sigurimi i automjeteve	50109		48.60	1,254.55		
7	Shitja e pasurisë komunale	50413		16,885.52	-		
II	Inspektimi	16645	9,620.00	8,505.00	10,079.30	88.41	
1	Gjohat nga inspektorët komunal	50104	5,700.00	7,125.00	8,559.30	125.00	
2	Gjohat mandatore - hudhja e mbeturinave	50114	1,200.00	-	-	-	
3	Taksa për pranimit teknik të lokaleve	50205	2,720.00	1,380.00	1,520.00	50.74	
III	Buxhet e Financë	17523	506,221.00	326,452.37	476,192.13	64.49	
1	Tatimi në pronë	40110	385,000.00	217,461.37	374,885.92	56.48	
2	Taksa për regjistrimin e automjeteve	50001	119,016.00	106,426.00	96,907.50	89.42	
3	Taksa për regjistrimin e trashigimisë –	50019	30.00	-	-	-	
4	Taksat për vërtetime dhe çertifikata tjera	50011	2,175.00	1,764.00	2,713.00	81.10	
5	Taks Administrative	50019		801.00	1,685.71		
IV	Zhvillimi Ekonomik - Planifikimi	48023	34,600.00	28,545.00	24,600.00	82.50	
5	Taksa komunale në biznes	50201	34,600.00	28,545.00	24,600.00	82.50	
2	Gjohat e biznesëve nga inspektorët financiarë	50104		-	-	-	
IV	Shërbimet Publike e Mbrojtja Civile	18023	950.00	5,368.60	1,105.00	565.12	
1	Taksa për leje parkingu	50008	450.00	4,170.00	405.00	926.67	
5	Shfrytëzim i pronës publike	50405	500.00	1,198.60	700.00	239.72	
V	Bujqësi dhe zhvillim rural	47023	39,080.00	12,386.80	51,939.67	31.70	
1	Ndërrimi i destinimit të tokës	50012	280.00	-	-	-	
2	Taksa tjera administrative për bujqësi	50016	1,800.00	3,308.00	5,554.56	183.78	
4	Participimet në bujqësi	50409	37,000.00	9,078.80	46,385.11	24.54	
VII	Gjeodezia, Kadastrri dhe Prona	65315	156,930.00	331,503.26	274,143.42	211.24	
1	Trashigimia – bartja, regjistrimi i pronës	50011	58,000.00	37,387.00	56,986.00	64.46	
3	Taksë për fletë-poseduese dhe kopje plani	50032	16,700.00	12,623.00	15,706.00	75.59	
4	Taksa administrative	50019	1,530.00	6,243.00	6,185.00	408.04	
5	Renta - shfrytëzimi i pronës publike	50405	21,500.00	134,179.15	31,484.50	624.09	
6	Qiraja nga objektet publike	50408	28,000.00	18,669.28	20,581.09	66.68	
7	Aktivitetet në terren për matje	50504	30,000.00	32,487.00	34,755.00	108.29	
8	Tax ndërrim destinimit tokës	50012	1,200.00	89,914.83	108,445.83	7,492.90	
VIII	Urbanizimi dhe Mbrojtja e Ambientit	66620	664,738.00	694,017.11	799,124.62	104.40	
1	Lejet ndërtimore	50009	465,738.00	555,913.17	547,057.26	119.36	
2	Taksat administrative	50019		1,750.00	2,600.00		
3	Të hyrat nga koncesioni	50417	141,000.00	52,891.60	188,884.60	37.51	
4	Takse komunale për leje mjedisi	50045	30,000.00	65,006.47	60,167.99	216.69	
0	Legalizimi i Objekteve Ndërtimore	50026	28,000.00	18,455.87	414.77	65.91	
IX	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	73032	26,300.00	16,761.00	14,634.00	76.19	
1	Taksa administrative DSHMS	50019	22,000.00	16,761.00	14,634.00	76.19	
a	Shtëpia e shëndetit OKMF	74400	31,150.00	36,823.00	31,544.00	118.21	
1	Participimi - arka	50409	25,300.00	32,083.00	26,984.00	126.81	
2	Çertifikatë mjeku	50024	5,850.00	4,740.00	4,560.00	81.03	
XI	Kultura, Rinia e Sporti	85023	4,180.00	522.00	664.00	12.49	
1	Qiraja nga objektet publike	50408	2,450.00	-	-	-	
2	Participimi nga KRS (biblioteka)	50409	1,730.00	522.00	664.00	30.17	
XII	Arsimi – qerdhja e fëmijëve	92650	73,030.00	52,829.00	44,669.00	72.34	
3	Participimi për kujdesin e fëmijëve	50409	71,030.00	52,829.00	44,669.00	74.38	
4	Participimi për kujdesin e fëmijëve-Bajë	50409	2,000.00	-	-	-	
GJITHSEJ TE HYRAT			1,619,389.00	1,577,915.18	1,786,631.99	97.44	
Te Hyrat tjera - Gjohat nga Trafiku, Gjykata, e tjera			264,882.00	184,781.50	149,061.00	69.76	
1	Të hyrat nga gjohat në trafik	50101	219,659.00	153,659.00	120,626.00	69.95	
2	Të hyrat nga gjohat e gjykatave	50102	45,025.00	31,025.00	28,345.00	68.91	
3	Të hyrat nga Agjensioni pyjor e tjera	50107	198.00	97.50	90.00	49.24	
GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE			1,884,271.00	1,762,696.68	1,935,692.99	93.55	

3. SHPENZIMET BUXHETORE JANAR-DHJETOR 2024

Shpenzimet e komunës për periudhën janar dhjetor 2024 janë realizuar përmes pesë kategorive ekonomike të parapara me Ligjin e buxhetit për vitin 2024 .

Në tabelën vijuese kemi paraqitur të dhënat për lëvizjen e të gjitha këtyre kategorive të shpenzimeve për vitin 2024 duke krahasuar shpenzimet e kësaj periudhe me shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit 2023 si dhe 2022 pjesëmarrjen e kategorive të veçanta të tyre në shpenzimet e gjithmbarshme komunale për periudhën raportuese.

Sipas tabelës mund të shihet se:

- Masa e përgjithshëm e paguar për paga dhe shtesa ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023 për 20.07 % kurse pjesëmarrja e pagave në shpenzimet e përgjithshëm komunale për këtë periudhë është 55.93 %.

- Mesatarja për të gjitha nën-kategoritë ekonomike për Mallrat dhe shërbime ka pasur ngritje 0.83 % në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Pjesëmarrja e mallrave dhe shërbimeve në shpenzimet e përgjithshme komunale është 11.91 %.

-Shërbimet Komunale kanë shënuar trendin e rënies të shpenzimit me periudhën paraprake kurse në shpenzimet e përgjithshme marrin pjesë me 1.45 % , arsyeja e rënies qëndron në faktin gjatë viteve të mëhershme janë paguar edhe obligime nga viti paraprak, ndërsa gjatë vitit 2024 ka pasur një azhuret me të madhë për këtë kryerje të obligimeve në këtë kategori.

-Subvencionet kanë shënuar rritje prej 10.44 % , kurse pjesëmarrja në shpenzimin e buxhetit 5.24 %.

Investimet Kapitale kanë shënuar rritje për 3.47 % , në shpenzim të buxhetit, kurse pjesëmarrja në shpenzimin e buxhetit është 25.47 %.

Në përgjithësi shpenzimet e gjithmbarshme komunale në vitin 2024 janë më të larta për 12.02 % me ato për periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike		
Pagat dhe Shtesat	11,719,493.30	55.93
Mallrat dhe Shërbimet	2,494,993.67	11.91
Shërbimet Komunale	303,121.92	1.45
Subvencionet	1,097,738.67	5.24
Investimet Kapitale	5,337,593.84	25.47
Gjithsej	20,952,941.40	100.00

TABELA NR. 3 Llojet e shpenzimeve sipas kategorive dhe nenkodeve

Nr. R	LLOJI I SHPENZIMEVE	Kodi ekonomik	Shpenzimi sipas viteve =		
			2022	2023	2024
1	Paga Neto	11111	6,805,252.51	8,235,590.56	8,129,144.17
